



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Nr. 60/₁₂.Prot

Tiranë më, 08.03.2019

Lënda: Dërgohen Vendimet e Bordit të AMF-së, nr. 26 dhe 27 të datës 04.03.2019.

SHOQËRISË “CREDINS INVEST” SH.A.

Rruga “Nikolla Tupe”, Nr.1, Kati 3, Tiranë

Ju bëjmë me dije se Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me Vendimet nr. 26 dhe 27 të datës 04.03.2019, në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 22, 37 të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, dhe neneve 12, 14, 23 të Ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, miratoi Zj. Estela Koçi si aksionar ndikues dhe ndryshimin e nenit 5 të statutit të shoqërisë administruese të fondit të pensionit dhe sipërmarrjes së investimeve kolektive “Credins Invest” sh.a.

Bashkëlidhur do të gjeni vendimet e Bordit të AMF-së.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin Koçi
Ervin Koçi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 26, datë 04.03.2019

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUTIT TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE TË
FONDIT TË PENSIONIT DHE SIPËRMARRJES SË INVESTIMEVE KOLEKTIVE
“CREDINS INVEST” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikës 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 22 të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar” dhe të neneve 12 dhe 14 të Ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjen e investimeve kolektive”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes të Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të nenit 5 të statutit të shoqërisë administruese të fondit të pensionit dhe sipërmarrjes së investimeve kolektive “Credins Invest” sh.a, si më poshtë vijon:

Neni 5

Kapitali i Shoqërisë

- 5.1 Kapitali i nënshkruar dhe i paguar tërësisht i shoqërisë është 95,822,394.00 lekë i përbërë prej 233,713.17 aksione me vlerë nominale 410 (katërqindedhjetë) lekë secili.
- 5.2 Kapitali aksionar i shoqërisë përbëhet tërësisht nga kontribute në para (likuide) dhe zotërohet nga aksionarët e shoqërisë si më poshtë:
 - a) Pjesëmarrja aksionare e “Bankës Credins” sh.a. është në nivelin 76.00 %, të kapitalit aksionar me barasvlerën në lekë prej 72,825,019.00 si dhe me 177,622.00 aksione.

Benuela Udin

- b) Pjesëmarrja aksionare e "SiCRED" sh.a., është në nivelin 12.00 %, të kapitalit aksionar me barasvlerën në lekë prej 11,498,687.00 si dhe me 28,045.58 aksione.
- c) Pjesëmarrja aksionare e Znj. Estela Koçi, është në nivelin 5.00 %, të kapitalit aksionar me barasvlerën në lekë prej 4,791,120.00 si dhe me 11,685.66 aksione.
- d) Pjesëmarrja aksionare e Z. Egi Santo, është në nivelin 3.5 %, të kapitalit aksionar me barasvlerën në lekë prej 3,353,784.00 si dhe me 8,179.96 aksione.
- e) Pjesëmarrja aksionare e Z. Genc Koxhaj, është në nivelin 3.5 %, të kapitalit aksionar me barasvlerën në lekë prej 3,353,784.00 si dhe me 8,179.96 aksione.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETAR

Pajtim MELANI



DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 27, datë 04.03.2019

PËR

MIRATIMIN E ZJ. ESTELA KOÇI SI AKSIONAR NDIKUES I "CREDINS INVEST"
SH.A. SHOQËRI ADMINISTRUESE E FONDIT TË PENSIONIT DHE
SIPËRMARRJES SË INVESTIMEVE KOLEKTIVE

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikës 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar, nenit 37 të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për Fondet e Pensionit Vullnetar" dhe të nenit 23 të Ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjen e investimeve kolektive", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes të Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

VENDOSI:

1. Miratimin e zj. Estela Koçi si aksionar ndikues i "Credins Invest" sh.a. shoqëri administruese e fondit të pensionit dhe sipërmarrjes së investimeve kolektive.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI



DREJTORI I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Errvin KOÇI

Benuela